

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-196/13

**Prishtinë,
5 mars 2014**

Në çështjen juridike të

N. R.L.

F.K. 10/1

R. N. K. B

B. Ub

S.

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

Kundër

Nuk dihet

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KPCC/D/R/191/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08628), të datës 13 shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 5 mars 2014, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hedhet si e pasafatshme ankesa e N. R. L. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/191/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08628), e datës 13 shkurt 2013.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 22 janar 2007, paraqitësja e kërkesës N. R. L. në cilësinë e gruas së bashkëshortit të ndjerë M.L., ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës, ku ka kërkuar ri-posedimin e një banese që ndodhet në komunën e Vushtrisë në Velika Rekë, në rrugën Milana Pribicevica, numër 41, me sipërfaqe prej 80.44 m². Kërkesa ishte regjistruar në AKP me numrin KPA08628.
2. Paraqitësja e kërkesës ka deklaruar se humbja e posedimit ishte rezultat i rrethanave në vitet 98/99 në Kosovë dhe se data e humbjes ishte 17 qershor 1999.
3. Së bashku me kërkesën , ajo ka paraqitur kopjen e një vendimi të Komisarariatit të Lartë për Refugjatë të Serbisë numër 350-6/569 të datës 8 tetor 1998, me anë të së cilit bartësit të supozuar të së drejtës pronësore i jepet e drejta e strehimit në pronën e kërkuar. AKP-ja e ka verifikuar pozitivisht këtë vendim. Me certifikatën nr. 019-923/1 të datës 28 nëntor 2011, Komisarati për Refugjatë e ka vërtetuar vendimin 350-6/569 të datës 8 tetor 1998.
4. Përveç kësaj, paraqitësja e kërkesës ka paraqitur një kopje të procesverbalit për pranim-dorëzimin e banesës të përpiluar nga Komisarati për Refugjatë nga Beogradi për pranim-dorëzimin e datës 27 tetor 1998. Ky procesverbal i pranimit-dorëzimit të banesës është vulosur me datën 30.08.1995. AKP-ja e ka verifikuar këtë dokument pozitivisht.

5. Për të dëshmuar lidhjen familjare, paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar në AKP certifikatën e vdekjes së bashkëshortit të saj të ndjerë, të lëshuar në Radljevo më 20 gusht 2004. Certifikata e vdekjes tregon se M. .L, i lindur me 1 maj 1953, shtetas i Republikës së Serbisë dhe Unionit të Serbisë dhe Malit të Zi, kishte vdekur më 19 gusht 2004 dhe se emri i gruas së tij ishte N. L.. Dokumenti ishte verifikuar pozitivisht nga AKP-ja.
6. Më 28 mars 2008, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një shenjë njoftuese në derën e banesës së kërkuar. AKP-ja e ka gjetur pronën të uzurpuar nga F K.i cili nuk kishte kërkuar ndonjë të drejtë ligjore ndaj pronës së kërkuar.
7. Më 22 nëntor 2011, AKP-ja e ka pyetur paraqitësen e kërkesës se nga cila kohë ajo kishte shfrytëzuar banesën dhe i ka kërkuar që të sillte dokumente për pagesën e shërbimeve komunale. Ajo ka thënë se nuk posedonte ndonjë dokument shtesë për të dëshmuar të drejtën pronësore, por do të përpiqej që t'i gjente ato. AKP-ja i ka dhënë asaj një afat prej 15 ditëve.
8. Me vendimin e tij KPCC/D/R/191/2013 të datës 13 shkurt 2013, KKPK-ja e ka refuzuar kërkesën mbi argumentet se e vetmja provë e paraqitur nga paraqitësja e kërkesës në mbështetje të kërkesës është vendimi i Komisarariatit të Lartë për Refugjatë të Serbisë, me anë të së cilit bartëses së supozuar të së drejtës pronësore i jepet e drejta e vendosjes në pronën e kërkuar.
9. Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar paraqitëses së kërkesës me 18 qershor 2012. Më 22 korrik 2013, ajo ka paraqitur ankesë nëpërmjet kopjes së pranuar të vendimit të KKPK-së, duke kundërshtuar atë mbi bazën e vërtetimit të pasaktë dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditëve të paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme. Afati për paraqitjen e ankesës ishte 18 korrik 2013, dhe ankesa ishte paraqitur nga Ljiljak me datë 22 korrik 2013. Gjykata Supreme ka vendosur në një rast të ngjashëm siç është rasti GSK-KPA-A-29/12 kur ankesa është ushtruar dy ditë pas afatit të paraparë.
11. Nga ajo që u cek më lartë, sipas nenit 196 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Udhëzim juridik:

12. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it